

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7019
E enjte, 12 tetor 2023
Çmimi 0.50 €

ShBA-ja i dhuron dronë Policisë së Kosovës

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NATO-ja THOTË SE RRIJTJA E PRANISË SË TRUPAVE TË SAJ NË KOSOVË ISHTE E RËNDËSISHME

FAQE 4-5



Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, e ka cilësuar të mërkurën të rëndësishëm shtimin e trupave të misionit paqeruajtës të aleancës në Kosovë, KFOR, pas rritjes së tensioneve në mes të Kosovës dhe Serbisë si pasojë e

sulmit të 24 shtatorit në veri nga një grup i armatosur serbësh në fshatin Banjskë në komunën e Zveçanit. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka falënderuar NATO-n për dërgimin e trupave shtesë me qëllim të rritjes së

sigurisë përgjatë kufirit Kosovë - Serbi. E analisti i sigurisë, Burim Ramadani, ka thënë se ngjarjet e 24 shtatorit 2023 në veri kanë hapur një faqe të re të kërcënimeve të sigurisë, duke theksuar se Kosova nevojë për garanci sigurie

AKTUALE



IZRAELI GRUMBULLON TRUPA
KËMBËSORIE NË KUFI ME GAZËN F. 2

LANSOHET FUSHATA "TË GËZOHENI
ME FËMIJË" F. 6

KMDLNJ-ja: LOJA E RREZIKSHME E
KONVERTIMEVE FETARE NË KOSOVË F. 7

EKONOMI



SI MBETI KOSOVA EDHE
PA TERMOCENTRAL,
EDHE PA 20 MILIONË EURO? F. 8

SPORT



KOSOVA SHPRESON
NË REZULTAT POZITIV
NË PËRBALLJEN ME ANDORRËN F. 10

**DËSHMITARI I 29
REFUZON TË DËSHMOJË
KUNDËR KRERËVE TË
UÇK-SË, MOHON SE KA
DHËNË NJË INTERVISTË
NË VITIN 2004** | FAQE 5



**OSMANI VIZITON
KOMPANINË PËR
PRODHIMIN E
ARMËVE NË
KROACI, KAP
ARMËN NË DORË** | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Erdogani: Izraeli po sillet si organizatë, jo si shtet

ANKARA, 11 TETOR - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, tha të mërkurën se Izraeli "nuk po sillet si një shtet, por si një organizatë", pasi ushtria izraelite po i vazhdon bombardimet pareshur në Rripin e Gazës qëkur u sulmua nga Hamasi në fundjavë. "Izraeli nuk

duhet të harrojë se, nëse sillet si një organizatë dhe jo si një shtet, do të përfundojnë duke u trajtuar si e tillë", tha Erdogan, duke i cilësuar si "metoda të turpshme" sulmet e ushtrisë izraelite në Gazën e mbipopulluar.

Të hënën Izraeli njoftoi rrethimin e plotë të Rripit të

Gazës, duke thënë se nuk do ta lejonte futjen e ushqimit dhe karburanteve.

Gati 60 % e të plagosurve në Gaza janë gra dhe fëmijë, sipas saj.

Erdogani theksoi se "bombardimi i zonave civile, vrasja e civilëve, bllokimi i ndihmave humanitare dhe

përpjekja për t'i paraqitur këto si arritje, janë veprime të një organizate dhe kjo të një shteti". "Ne mendojmë se lufta duhet të ketë etikë dhe të dyja palët duhet ta respektojnë këtë. Fatkeqësisht, këto parime po shkelen rëndë në Izrael dhe në Gaza", tha ai, duke e dënuar "vrasjen e



civilëve në territorin izraelit" dhe "masakrimin e njerëzve të pafajshëm në Gaza, të cilët përballeshin me bombardime të vazhdueshme".

Izraeli grumbullon trupa këmbësorie në kufi me Gazën



JERUSALEM, 11 TETOR - Forcat Mbrotjtëse të Izraelit (IDF) kanë dërguar trupa këmbësorie, artileri dhe mbi 300 000 rezervistë në afërsi të kufirit me Gazën, pesë ditë pas sulmit befasues të militantëve të Hamasit në jug të Izraelit. Forcat izraelite njoftuan të mërkurën se e kanë rindërtuar barrierën përreth Gazës, të cilën e thyen militantët e Hamasit për ta kryer sulmin më vdekjeprurës palestinez në historinë e Izraelit. Ushtria izraelite tha të mërkurën se numri i përgjithshëm i të vrarëve në

Izrael ka arritur në 1 200 dhe se më shumë se 2 700 njerëz janë plagosur.

"Ata janë afër Rripit të Gazës duke u përgatitur ta ekzekutojnë misionin që u është dhënë nga Qeveria e Izraelit - dhe ky mision është për t'u siguruar se Hamasi në fund të kësaj lufte nuk do të ketë më ushtri me të cilën mund t'i kërcënojë apo vrasë civilët izraelitë", tha IDF-ja të mërkurën.

Luftimet dhe skenat nga Gaza në ditët në vijim "do të jenë të papërballueshme dhe të vështira për t'u kuptuar", sipas

IDF-së.

Izraeli i vazhdoi bombardimet e paseshura në Gaza gjatë natës mes 10 dhe 11 tetorit, duke i vrarë së paku 30 persona.

Numri i përgjithshëm i të vrarëve në enklavën e mbipopulluar bregdetare është rritur në 950, ndërsa janë plagosur 5 000 njerëz, tha Ministria e Shëndetësisë e Gazës.

Të hënën militantët e Hamasit kërcënuan se do t'i vrasin pengjet izraelite, civilë dhe ushtarë, nëse Izraeli vazhdon ta bombardojë Gazën pa

paralajmërim, por nuk ka ndonjë indikacion që e kanë bërë një gjë të tillë derisa ushtria izraelite nuk po i ndal sulmet ajrore.

Ministri i Mbrotjtjes i Izraelit, Yoav Gallant, tha duke u folur ushtarëve afër kufirit me Gazën se "Hamasi e donte një ndryshim dhe do ta ketë atë. Nuk do të mbetet asgjë nga ajo që sot është në Gaza". "Ne e kemi nisur ofensivën nga ajri, më vonë do të vijmë përmes tokës. Ne jemi duke e kontrolluar këtë zonë që nga Dita 2 dhe jemi në ofensivë. Vetëm sa do të shtohet", tha ai.

Së paku 1 000 militantë të armatosur, të cilët ishin futur në Izrael nga Gaza, u vranë, raportojo gazeta izraelite "Hayom".

Izraeli i tërhoqi trupat nga Gaza në vitin 2005, 38 vjet pas okupimit dhe i ka vënë bllokadë kësaj enklave qëkur Hamasi e mori në dorë pushtetin në vitin 2007.

Policia izraelite i vret dy palestinezë në lindje të Jerusalemit

Policia kufitare e Izraelit i ka vrarë dy palestinezë në lindjen e aneksuar të Jerusalemit, pasi ata kishin hedhur fishekzjarrë dhe gurë në drejtim të oficerëve, njoftoi policia izraelite të mërkurën. Incidenti ndodhi të martën vonë në lagjen Silwan derisa oficerët po patrullonin në këtë zonë, tha policia kufitare në një komunikatë. Një oficer u godit nga fishekzjarrët, sipas saj. "Si përgjigje ndaj kërcënimeve me jetë, oficerët e policisë kufitare kanë shtënë me armë ndaj dy sulmuesve", të cilët më vonë u konfirmuan të vdekur, thuhet në komunikatë.

Gjermania me ndihmë të re për Ukrainën në vlerë prej 1 miliard eurosh

BERLIN, 11 TETOR - Gjermania ka njoftuar për një pako të re të ndihmës në vlerë prej rreth 1 miliard eurosh. Ministria e Mbrotjtjes e Gjermanisë shtoi se pakoja e ndihmës ushtarake përfshin pajisje për mbrojtje ajrore, armë dhe makina tokësore.

"Gjermania do të vazhdojë ta mbështesë Ukrainën me atë që ka nevojë në mënyrë më urgjente: me mbrojtje ajrore, municion dhe tanke", tha ministri gjerman i Mbrotjtjes, Boris Pistorius. "Me këtë pako të re të ndihmës ne do ta rritim gatishmërinë

operacionale të forcave të armatosura ukrainase për maut në vijim".

Pistorius tha se në pakon e re përfshihen sisteme raketore Patriot, por edhe sisteme shtesë të llojit IRIS-T dhe tanket Gepard.

Gjermania, po ashtu, do t'i

ofrojë Ukrainës makina ushtarake, por edhe pajisje të tjera të paspecifikuara në vlerë prej 20 milionë eurosh. Që nga qershori Ukraina, që përballet me pushtimin rus që nga shkurti i vitit të kaluar, ka nisur një kundëroffensivë në jug dhe



lindje. Megjithatë, kjo kundëroffensivë është duke shkuar më ngadalë sesa që pritej.

Osmani viziton kompaninë për prodhimin e armëve në Kroaci, kap armën në dorë

PRISHTINË, 11 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë vizitës së saj në Kroaci, ka vizituar kompaninë për prodhimin e armëve 'HS

Product'. Ajo në fotografi shihet duke provuar armët e kësaj kompanie. Osmani gjatës kësaj vizite ka theksuar se Kosova dhe Kroacia e kuptojnë dhe

përkrahin njëra-tjetrën pa kushte. "Jemi me fat që kemi një aleat të tillë në krah, që na qëndron pranë në kohë të mira e në kohë të vështira. Kjo

përkrahje po dëshmohet edhe këto ditë teksa Kosova po ballafaqohet me pasojat e aktit të agresionit të Serbisë", ka thënë Osmani.



ShBA-ja i dhuron dronë Policisë së Kosovës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 TETOR - Shtetet e Bashkuara ia kanë dhuruar Policisë dhe Inspektoratit Policor të Kosovës shtatë dronë të mërkurën, të cilët do t'i shërbejnë kësaj force për misione vëzhguese dhe taktike, sipas ambasadorit amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier.

Gjatë një ceremonie të nënshkrimit të donacionit në Prishtinë, Hovenieri tha se ndihma më e fundit e SHBA-së për institucionet e zbatimit të ligjit në Kosovë "pasqyron

përkushtimin afatgjatë të tyre për zhvillimin e Policisë së Kosovës".

"Kjo është dëshmi shtesë e besimit të SHBA-së ndaj Kosovës për kryerjen e misionëve të pavarura në luftë kundër narkotikëve dhe zbatim të ligjit", tha Hovenier.

Donacioni amerikan për Policinë e Kosovës vjen rreth tri javë pasi ajo u sulmua nga një grup i armatosur serbësh në fshatin Banjaskë, në komunën e Zveçanit, më 24 shtator, ku mbeti i vrarë rreshteri Afrim Bunjaku. "Duke e parë shkallën e aktiviteteve kriminale të grupeve të organizuara në rajon, këto mjete

fluturuese pa pilotë do të jenë një burim jetik i organeve të zbatimit të ligjit në Kosovë për t'i luftuar veprimtaritë kriminale në tokë dhe në ajër", shtoi Hovenier.

Policia e Kosovës përdori dronë për ta xhiruar dhe identifikuar organizatorin e sulmit në Banjaskë, Millan Radoiçiq, i cili më vonë e mori përgjegjësinë për sulmin.

Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, tha se policia do të përpiqet t'i përdorë dronët e dhuruar nga SHBA-ja në mënyrën më të mirë të mundshme për të forcuar siguri sa më të madhe për qytetarët e gjithë Kosovës. "Donacioni do të ndikojë

pozitivisht në ngritjen e kapaciteteve të policisë për ta menaxhuar situatën në terren, përfshirë monitorimin e kufijve të Kosovës dhe në operacione të tjera të hetimit që Policia e Kosovës do t'i kryejë në të ardhmen", tha Hoxha.

Ndërsa kryeshefi i IPK-së, Kushtrim Hoda, ka theksuar përkushtimin e IPK-së dhe bashkëpunimin me menaxhmentin e lartë të policisë dhe partnerëve amerikanë për t'i mbajtur lart standardet profesionale dhe integritetin e zyrtarëve policorë. Ai ka thënë se ky donacion do të shërbejë për t'i

forcuar kapacitetet e tyre profesionale në mënyrë që qytetarëve t'u ofrohet siguri në mënyrë efektive, të përgjegjshme e demokratike.

Serbia i ka hedhur poshtë akuzat e Kosovës se ajo qëndron pas sulmit të cilësuar nga autoritetet kosovare si "tentim për ta aneksuar veriun e Kosovës".

Më 3 tetor Radoiçiqi, ish-kryetar i Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve në Kosovë që ka mbështetjen e Beogradit, u arrestua në Serbi, u mor në pyetje dhe u urdhërua të mbahej në paraburgim policor deri në 48 orë para se të lirohej një ditë më vonë.

Shqipëria për herë të dytë bëhet anëtare e Këshillit të të Drejtave të Njeriut

TIRANË, 11 TETOR - Shqipëria është zgjedhur anëtare e Këshillit të të Drejtave të Njeriut për periudhën 2024-2026. Pas votimit me 123 vota për në Asamblesë e Përgjithshme të OKB-së, Shqipëria bëhet për herë të dytë anëtare në këtë Këshill. Lajmin e dha në rrjetin social "X", ministri i Jashtëm Igli Hasani, që e cilëson si një arritje të madhe të politikës dhe diplomacisë së jashtme shqiptare. "Një tjetër demonstrim i besimit

nga shtetet anëtare të OKB-së për rolin e Shqipërisë në çështjet ndërkombëtare. Këtë herë plotësisht të përkushtuar për mbrojtjen dhe promovimin e të Drejtave të Njeriut kudo dhe për të gjithë", ka shkruar Hasani.

Objektivi kryesor i Shqipërisë, si anëtare e Këshillit të të Drejtave të Njeriut, do të jetë të punojë brenda Këshillit dhe sistemit të Kombeve të Bashkuara për ta garantuar



respektimin universal të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, për të gjithë

individët pa diskriminuar askënd. Vendi ynë do të

bashkëpunojë ngushtë me shtetet e tjera anëtare të OKB-së, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të gjithë partnerët për zbatimin e këtyre angazhimeve. Këshilli, i cili është i ngarkuar me përgjegjësinë për t'i mbrojtur dhe avancuar të drejtat e njeriut në nivel global, përbëhet nga 47 shtete anëtare të zgjedhura me votim të fshehtë nga shumica e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme.



NATO-ja thotë se rritja e pranisë së trupave të saj në Kosovë ishte e rëndësishme

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, e ka cilësuar të mërkurën të rëndësishëm shtimin e trupave të misionit paqeruajtës të aleancës në Kosovë, KFOR, pas rritjes së tensioneve në mes të Kosovës dhe Serbisë si pasojë e sulmit të 24 shtatorit në veri nga një grup i armatosur serbësh në fshatin Banjskë në komunën e Zveçanit. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka falënderuar NATO-n për dërgimin e trupave shtesë me qëllim të rritjes së sigurisë përgjatë kufirit Kosovë - Serbi. E analisti i sigurisë, Burim Ramadani, ka thënë se ngjarjet e 24 shtatorit 2023 në veri kanë hapur një faqe të re të kërcënimeve të sigurisë, duke theksuar se Kosova nevojë për garanci sigurie

nga kufiri me Kosovën. Serbia i ka hedhur poshtë akuzat e Kosovës se ajo qëndron pas sulmit të cilësuar nga autoritetet kosovare si "tentim për ta aneksuar veriun e Kosovës".

Tashme në Kosovë Turqia udhëheq komandën e KFOR-it. Gjeneralmajor Ozkan Ulutash e ka marrë të martën detyrën e komandantit të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, në një kohë kur tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë janë të larta pas sulmit të muajit të kaluar në veri të vendit.

Duke folur pasi e mori detyrën, Ulutash tha: "Si komandanti i parë turk i KFOR-it e kuptoj përgjegjësinë që e kam marrë. Duke e parë gjendjen e ndjeshme në Kosovë, po e marr komandën me përkushtim për t'i bërë të gjitha përpjekjet dhe për ta

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 11 TETOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, e ka cilësuar të mërkurën të rëndësishëm shtimin e trupave të misionit paqeruajtës të aleancës në Kosovë, KFOR, pas rritjes së tensioneve në mes të Kosovës dhe Serbisë si pasojë e sulmit vdekjeprurës ndaj Policisë së Kosovës në veri të vendit

muajin e kaluar.

Më 6 tetor NATO-ja njoftoi se 200 ushtarë britanikë mbërritën në Kosovë, të cilët iu bashkuan kontingjentit britanik prej 400 ushtarësh që ndodhej tashmë në Kosovë. "Kemi parë rritje të re të tensioneve atje, prandaj është e rëndësishme që NATO-ja ka rritur praninë e saj në Kosovë", ka thënë Stoltenbergu të mërkurën para takimit dyditor në Bruksel të ministrave të Mbrojtjes së

vendeve anëtare të NATO-s, ku do të diskutohet edhe për misionin e kësaj aleance në Kosovë.

Më 6 tetor Gjermania tha se do t'i dërgojë rreth 150 ushtarë në Kosovë në prill të vitit të ardhshëm.

Vendimi i NATO-s për shtimin e trupave paqeruajtëse në Kosovë erdhi rreth dy javë pasi Policia e Kosovës u sulmua nga një grup i armatosur serbësh në fshatin Banjskë, në komunën e Zveçanit,

më 24 shtator, ku mbeti i vrarë rreshteri Afrim Bunjaku. Në luftimet që pasuan pastaj në manastirin e fshatit u vranë tre sulmues serbë. Pak ditë pas sulmit, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian ngritën shqetësime se Serbia po zhvendoste trupa ushtarake përgjatë kufirit me Kosovën. Kjo u mohua nga Serbia.

Më 3 tetor, Shtëpia e Bardhë tha se Serbia ka filluar t'i tërheqë trupat

Dëshmitari i 29 refuzon të dëshmojë kundër krerëve të UÇK-së, mohon se ka dhënë një intervistë në vitin 2004

HAGË, 11 TETOR - Në seancën e së mërkurës në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë, në gjykimin ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, kryetari i trupit gjykues, Charles Smith III, ka njoftuar se ka caktuar një avokat mbështetës për dëshmitarin e 29 të mbrojtur të Prokurorisë, duke informuar se është i lirë që të konsultohet me të. Avokati është caktuar pas kërkesës së këtij dëshmitari, me arsyetimin se nuk po i kuptonte gjërat mirë, raporton "Betimi për Drejtësi". Në këtë seancë, prokurorja e Zyrës

së Prokurorit të Specializuar (ZPS), Clare Lawson, ka njoftuar se do të jetë ajo që në sesionin e paradites do ta marrë në pyetje dëshmitarin e 29. Pasi ka filluar seanca e së mërkurës, kryetari i trupit gjykues, Smith III, tha se për sigurinë e dëshmitarit seanca do të vazhdojë e mbyllur. Por, pas kësaj, avokati mbështetës i dëshmitarit të 29 ka thënë se klienti i tij nuk po ndihet mirë, duke thënë se ai nuk është i gatshëm të dëshmojë, por është i gatshëm të shkojë në burg. "Klienti im është shumë i stresuar, nuk është i gatshëm të japë dëshmi, por i gatshëm të shkojë në burg", tha ai. Avokati

mbështetës i dëshmitarit 29 e tha këtë pasi kanë filluar pyetjet e prokurorës Clara Lawson për dëshmitarin.

Tutje, avokati kërkoi një pushim 30-minutësh që edhe njëherë të konsultohet me dëshmitarin e 29 të Prokurorisë Speciale që të vendoset për hapat e mëtuajtshëm.

Paraprakisht, prokurorja Clara Laëson e pyeti dëshmitarin lidhur me një intervistë që, sipas saj, e kishte dhënë në vitin 2004, por ai e mohoi ta këtë bërë.

Pas disa pjesëve të seancave të mbyllura dhe pushimeve, trupi gjykues ka vendosur që dëshmitari i mbrojtur i Prokurorisë, i 29-ti me

radhë, të mos e vazhdojë të mërkurën dëshminë, por të hënën, më 16 tetor.

Pas këtij vendimi të cilin e bëri me dije kryetari i trupit gjykues Charles Smith III, dëshmitari i mbrojtur deklaroi se i duhet një muaj kohë. "E kuptoj, edhe ju duhet ta kuptoni që mua më duhet një muaj ditë kohë", tha dëshmitari i 29-të.

Por, kjo kërkesë u kundërshtua nga trupi gjykues. Ndërsa dëshmitari tha se nuk ka zgjidhje tjetër përveç se të shkojë në burg. "Ju i dini masat e juaja edhe vazhdojeni procesin edhe drejtomëni ato, ju thashë edhe më herët, në burg edhe s'ka tjetër, gjendja ime nuk

është e mirë", tha dëshmitari i mbrojtur.

Paraprakisht, kryetari i trupit gjykues tha se dëshmitari duhet të mbetet në juridiksionin e kësaj gjykate, në mënyrë që të jetë në dispozicion për të kontaktuar me avokatin mbrojtës. "Dëshmitari mbetet në juridiksionin e kësaj gjykate në mënyrë që të jetë në dispozicion për të kontaktuar me avokatin mbrojtës dhe në mënyrë që të ketë ndihmë psikiatrike dhe të sigurisë nëse lind nevoja", tha kryetari i trupit gjykues, Charles Smith III.

Dëshminë në seancë të mbyllur e ka vazhduar të mërkurën dëshmitari i 30.



përdorur gjithë përvojën për t'u siguruar se kjo njësi e shquar do të shërbejë suksesshëm në të ardhmen siç ka bërë në të kaluarën".

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë vizitës së saj në Kroaci, ka falënderuar NATO-n për dërgimin e trupave shtesë me qëllim të rritjes së sigurisë përgjatë kufirit Kosovë - Serbi. Sipas presidentes Osmani, Kosova ka nevojë për mbështetje në këto çaste të vështira, ndaj ka theksuar se Kosova llogarit në përkrahjen e vazhdueshme të Kroacisë në procesin e anëtarësimit në Këshillin e Evropës, Bashkimin Evropian, NATO dhe organizata të tjera ndërkombëtare si dhe në ballafaqimin me sfida të sigurisë.

"Kosova ka nevojë për garanci sigurie"

Burim Ramadani, analist i sigurisë, ka thënë se ngjarjet e 24 shtatorit 2023 në veri kanë hapur

një faqe të re të kërcënimeve të sigurisë në mënyrë krejtësisht të ngjashme me ato që janë parë në vitet 2014-2015 në lindje të Ukrainës, përkatësisht në rajonin e Donetskut.

Në një intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Ramadani ka thënë se atë që rusët e kishin bërë në Donetsk, Serbia tentoi ta shtrijë praktikisht edhe në veri të Kosovës. Ai ka theksuar se ende rreziqet dhe kërcënimet e sigurisë janë serioze. "Serbia ka hapur një fazë të re të tentimit për destabilizim të Ballkanit. Po e bën në mënyrë krejtësisht të çmendur, sepse po dëshiron të tentojë të luftojë me të njëjtin armik ndaj të cilit e ka humbur luftën në vitin 1999. Pra, të luftojë edhe kundër Kosovës dhe kundër NATO-s në të njëjtën kohë. Fatkeqësisht, NATO po e mban Serbinë edhe më tutje në Partneritet për Paqe. Paramendojeni! Serbia në Kosovë rrezikon pikërisht ushtarët e NATO-s, ndërsa në rajone të tjera bashkë me NATO-n ofron paqe.

Kjo është më shumë se hipokrizi. Prandaj, unë besoj plotësisht se NATO do ta përzë Serbinë nga Partneriteti për Paqe. Serbia ka dëshmuar që nuk është partnere serioze dhe kredibile për operacione të përbashkëta me NATO-n në paqe. Ajo është kundërshtarë e NATO-s, sepse të tillë e ka padronin, përkatësisht Putinin. Kështu, Serbia edhe njëherë i ka shërbyer qëllimit nacional të Rusisë. Ka tentuar të nisë një konflikt të hapur në Ballkan, kësaj radhe edhe kundër NATO-s. Qëllimi është i identifikueshëm, sepse Rusisë i duhet dëshpërimisht të hapen konflikte në zona të tjera të botës, ku NATO dhe ShBA-ja janë të interesuara të ketë paqe dhe stabilitet", ka thënë Ramadani. Ai ka theksuar se institucionet e sigurisë duhet ta vazhdojnë punën e tyre në nivel të lartë të vigjilencës, duke pasur parasysh se operacioni i Serbisë nuk beson të ketë përfunduar. "Koordinimi midis institucioneve të sigurisë

është i domosdoshëm dhe duhet vazhdimisht të jetë i plotë", ka thënë ai.

Ramadani ka thënë se fokusi i Kosovës duhet të jetë NATO. "Edhe për faktin që shumica e shteteve të BE-së janë anëtare të NATO-s, edhe për faktin që NATO udhëheq trupat ushtarake në Kosovë, edhe për faktin që NATO e ka për mision ruajtjen e Kosovës nga invazioni serb. Kur situata në terren merr dimension serioz të sigurisë, NATO është ajo që duhet të prijë në vendosmërinë e saj", është shprehur Ramadani, duke shtuar se Kosova duhet të jetë e mirorganizuar, me të gjithë institucionet që ta promovojë qëllimin nacional të saj për anëtarësim të privilegjuar në NATO. "Pra, Kosova duhet të jetë anëtare e NATO-s në proces të privilegjuar. Të ndërtuar enkas për Kosovën, të dizajnuar në kuptimin procedural vetëm për Kosovën", ka thënë ai.

Por, për të shërbyer në këtë

qëllim, Ramadani ka thënë se pothuajse gjithçka në Kosovë duhet të funksionalizohet më mirë dhe më ndryshe. "Për shembull, pse Kosova pas 24 shtatorit 2023 nuk i ka nisur të paktën 10 diplomatë që të punojnë në Bruksel, të komunikojmë me NATO-n, me shtetet anëtare të NATO-s? Kush e ndalon Kosovën që t'i shumëfishojë diplomatët apo të krijojë ekipe profesionale për ta promovuar rastin e Kosovës në Bruksel apo në shtetet anëtare të NATO-s?", ka thënë Ramadani.

Ai ka shtuar se Kosova ka nevojë për garanci sigurie. "Garancitë në këtë kuptim nuk janë aspekte deklarative, por konkrete dhe praktike. Një hapje e shtegut për Kosovën në NATO do ta ndihmonte edhe sigurinë e stabilitetin rajonal, por në një aspekt do t'i ndihmonte edhe proceset politike sikurse është edhe dialogu Kosovë - Serbi", ka thënë Burim Ramadani, analist i sigurisë.

Osmani dekoron post mortem me Medaljen Presidenciale të Meritave, Milan Shuflajn, Vinçenc Gjinin dhe Shime Deshpalin

PRISHTINË, 11 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, gjatë vizitës zyrtare në Kroaci, i ka ndarë post mortem, Medaljen Presidenciale të Meritave, albanologut e historianit kroat Milan Shuflaj, Vinçenc Gjinin, kompozitor, pedagog dhe figurë e shquar e muzikës shqiptare dhe Shime Deshpalit, muzikolog dhe shkrimtar shqiptar i Arbneshit të Zarës.

Sipas presidentes Osmani, Milan Shuflaj është meritues për ndriçimin dhe trajtimin e problemeve të ndryshme në fushën e historisë mesjetare shqiptare, por edhe në fushën kërkimore të albanologjisë. Ndërkaq Vinçenc Gjini, sipas presidentes, kultivoi traditën tonë të muzikës, sikundër që u mor me studime nga fusha e artit muzikor,

duke lënë gjurmë me angazhimin në disa institucione kulturore të Kosovës.

Edhe të dekoruarin e tretë, Shime Deshpalin, muzikologun dhe shkrimtarin shqiptar të Arbneshit të Zarës, Osmani e vlerësoi për gjithë veprimtarinë e tij jetësore kushtuar muzikës, ruajtjes së traditës shqiptare dhe kultivimit të saj. "Nëpërmjet pasionit të tyre dhe punës së palodhshme ata kanë hedhur dritë mbi aspektet unike dhe shpesh të nënvlerësuara të identitetit shqiptar. Puna e tyre shërben si një urë lidhëse që lidh brezat e kaluar, të tashmen dhe të ardhmen, duke siguruar që thesaret e trashëgimisë shqiptare të mos humbasin", ka theksuar Osmani.



Kuvendi do të diskutojë për propozim-rezolutën për mbështetjen urgjente financiare të policisë

PRISHTINË, 11 TETOR - Kuvendi i Kosovës do të mbajë seancë të jashtëzakonshme të enjten, në të cilën seancë pikë e rendit të ditës do të jetë "Shqyrtimi i propozim-rezolutës për mbështetjen urgjente financiare për Policinë e Kosovës". Kjo kërkesë për seancë të jashtëzakonshme është bërë nga kryetari i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, në emër të deputetëve nënshkrues. "Policia e Kosovës, si një prej institucioneve më të rëndësishme të sigurisë në Republikën e Kosovës, zyrarët e së cilës me vetëmohim dhe përgjegjësi të lartë, në çdo kohë e çdo rrethanë, janë në nivelin më të mirë të detyrës, për fat të keq, janë diskriminuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Fakti se, që nga hyrja në fuqi (05 shkurt 2023) e Ligjit 08/L-196 për Pagat në Sektorin



Publik, zyrarëve policorë u është ndaluar shtesa e rrezikshmërisë, paraqet një vendim te padrejtë që ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e tyre, të familjeve të tyre dhe në vullnetin dhe motivin përballë punës së përditshme sfiduese. Janë bërë tetë muaj që Policia e Kosovës nuk është duke i gëzuar shtesat e

rrezikshmërisë. Që nga fillimi i ndalimit të kësaj shtese ka pasur paqartësi dhe premtime të mbajtura nga zyrarët qeveritarë. Policia e Kosovës është ende në pritje të ekzekutimit të kësaj pagese", thuhet në kërkesën për seancë.

Aty thuhet se është koha e fundit

për të marrë masa të menjëhershme për miratimin e Ligjit për Pensionim të Parakohshëm dhe pagesën e sigurimit shëndetësor për zyrarët policorë.

Dokumenti përmban edhe nënshkrimet e 33 deputetëve të grupit parlamentar të PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së.

Sipas draft-rezolutës, thuhet se duhet të obligohet qeveria që brenda afatit prej 15-ditësh nga miratimi i rezolutës, të bëjë ndarjen e mjeteve të nevojshme financiare për pagesën e shtesës së rrezikshmërisë për Policinë e Kosovës dhe atë në mënyrë retroaktive nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (për secilin muaj). Të obligohet qeveria që ta propozojë buxhetin e nevojshëm për vitin e ri fiskal 2024 për

mbulimin e pagesës së sigurimit shëndetësor për të gjithë zyrarët policorë të Kosovës nga janari 2024 dhe të obligohet qeveria që brenda afatit prej 60-ditësh nga miratimi i kësaj rezolute, ta marrë nismën për hartimin, propozimin dhe miratimin e Projektligjit për Pensionim të Parakohshëm të zyrarëve policorë të Policisë dhe punonjësit e inspektoratit.

Dhe të zotohet që shqyrtimi parlamentar i Projektligjit nga pika 3 e kësaj rezolute, të bëhet në procedurë të përshpejtuar në pajtim me rregullat e punës së Kuvendit. "Betimi për Drejtësi" më 7 tetor 2023 transmetoi hulumtimin "Nëpërkëmbja e statusit të policëve, saga e tenderit për të mbathur çizmet", ku flitet për sagën e tenderëve problematikë për t'ua siguruar kushtet elementare zyrarëve policorë.

Lansohet fushata 'Të gëzoheni me fëmijë'

PRISHTINË, 11 TETOR - Të mërkurën është bërë lansimi i fushatës "Të gëzoheni me fëmijë", e udhëhequr nga UNFPA në partneritet me IPKO Foundation, në shënim të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijës Vajzë. Nga të pranishmit u pohua se fushata ka për qëllim ta rrisë ndërgjegjësimin në lidhje me çështjen sensitive të abortit selektiv në Kosovë dhe ndërlihdjen e saj me qasjen e pabarabartë të vajzave në edukim me qëllim të ndërmarjes së nismave më efektive për ta adresuar këtë shqetësim.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili u adresua me një video-mesazh gjatë eventit, tha se: "Vajza është dhurata më e çmuar. I duhet shtëpisë një djalë, është një shprehje që ende e dëgjojmë në shoqërinë tonë. Dukuria që prish raportin natyror të lindjeve nuk duhet të ketë

vend më në Kosovë. Vajza jonë është dhurata më e çmuar për mua dhe Ritën. T'i themi jo praktikës dhe preferencës për djalë, sepse kush ka vajzën botën ka", ka thënë ai.

Ndërkaq ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka thënë se gratë dhe vajzat kanë qenë çdoherë promotorë të lëvizjeve në çdo institucion. "Kjo ditë nxjerr në pah barrierat me të cilat përballen gratë dhe vajzat. Nuk kemi të dhëna të sakta për abortin dhe kjo është një sfidë. Në vitin 2022 janë raportuar më shumë se 1 200 aborte. Sa më të forta të jenë vajzat aq më e fortë është edhe shoqëria", ka thënë ministri Vitia.

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka thënë se qasja në arsim do të jetë e barabartë për të gjithë, sidomos për vajzat.



Sistemi prokurorial po angazhohet për realizimin e obligimeve për integrimet evropiane

PRISHTINË, 11 TETOR - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial i Kosovës (KPK), Jetish Maloku, ka zhvilluar një takim pune me shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Tomas Szunyog, me bashkëpunëtorë. Në fokus të takimit në mes të Malokut dhe Szunyogut ishte diskutimi për shtimin dhe thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në mes të sistemit prokurorial dhe mekanizmave të Zyrës së BE-së në Kosovë lidhur me zbatimin e sundimit të ligjit dhe angazhimet e tjera me

interes të përbashkët. Me këtë rast, kryesuesi Maloku e informoi nga afër ambasadorin Szunyog për zhvillimin e aktiviteteve që po bëhen për realizimin e obligimeve që dalin në procesin e reformës së sistemit të drejtësisë në Kosovë, të cilat kanë të bëjnë, përveç të tjerave, me fuqizimin e transparencës publike, efektivitetin, efikasitetin dhe llogaridhënien gjatë procesit të punës. Ai tha se në mënyrë të veçantë sistemi prokurorial

është duke u angazhuar edhe për realizimin e obligimeve që dalin në rrugën e integriteteve evropiane. Po në këtë kontekst, shefi e BE-së në Kosovë, duke falënderuar për pritjen, theksoi gatishmërinë dhe përkushtimin e Zyrës së BE-së në Kosovë për ta ofruar ndihmën e nevojshme drejt fuqizimit të mëtejshëm të sundimit të ligjit në Kosovë. Në takim të dy bashkëbiseduesit shprehën vlerësimin e përbashkët për rritjen e bashkëpunimit në të ardhmen.



KMDLNj-ja: Loja e rrezikshme e konvertimeve fetare në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 TETOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut ka reaguar ndaj rastit të fundit në medie, se një shtetase gjermane u konvertua në islam me pëlqimin dhe vullnetin e saj në Xhaminë "Sinan Pasha" në Prizren dhe një rast tjetër, se në Kishën e "Shën Abrahamit" në Llapushnik një banor i Negrocit u konvertua duke e pranuar besimin e krishterë dhe u pagëzua me emrin Martin Krasniqi. "Sipas informatës nga kjo kishë, brenda disa ditëve do të ketë edhe konvertime të tjera në ndërkohë që me qindra të tjerë po presin të konvertohen apo, siç thonë ata: 'po iu kthehen rrënjëve të besimit të të parëve ...'. Jo fort moti besimin islam e pranoi edhe një serb duke u pagëzuar me një emër mysliman dhe të cilin Hoxha Shefqet Krasniqi e madhëroi aq shumë sikur të ishte njëri ndër themeluesit e këtij besimi. Është bërë si rregull që gjatë festave të fundvitit përkatësisht Festave të Krishtlindjeve në Katedralen e Prishtinës bëhen konvertime me publicitet mediatic sikur që kjo të ishte ngjarje me rëndësi dhe me interes të përgjithshëm publik dhe shoqëror e jo një çështje krejtësisht personale dhe private që nuk meriton asnjë publicitet, pavarësisht



besimit që e lë mbrapa apo atij që e pranon. Kjo garë se kush më shumë po konverton dhe se kush më shumë po fiton publicitet me këto konvertime për KMDLNj-në paraqet shqetësim të madh aq më parë që kjo pastaj po përcillet me gjuhë të urrejtjes midis besimeve e që më parë për shqiptarët ka qenë e huaj dhe e papranueshme", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

KMDLNj-ja ka theksuar se respekton të gjitha besimet dhe mbron të drejtën e ushtrimit të lirë të fesë e që është e garantuar me ligj dhe, sipas saj, në këtë drejtim Kosova njihet si një vend që i respekton këto të drejta pavarësisht besimit që e kanë apo numrit të besimtarëve që e praktikojnë besimin që i takojnë.

KMDLNj ka potencuar se është kundër gjuhës së urrejtjes e cila

po shpërndahet në medie duke e konsideruar besimin si çështje private dhe personale e jo si mjet apo mundësi për të dominuar një besim në dëm të besimit tjetër. "Për KMDLNj-në është i papranueshëm çdo diskriminim apo ndërhyrje në vullnetin e vet besimtarit për t'u konvertuar duke i dhënë publicitet të panevojshëm mediatic. KMDLNj nuk e kupton se çfarë interesi publik

dhe shoqëror kanë lajmet se sa persona janë konvertuar dhe nëse këtë e kanë bërë me vullnetin e tyre. Këto tendenca konfrontuese dhe përpjekje për mbizotërim për konvertime, KMDLNj i konsideron si rrezik për të ardhmen dhe legalizim të një gjuhe që është në kundërshtim të plotë me bindjet dhe mësimet fetare, pavarësisht besimit", thuhet në reagimin e KMDLNj-së.

Tahiri për ndërkombëtarët: Po vazhdon retorika irrituese për Banjskën, Serbia ende nuk u ndëshkua

PRISHTINË, 11 TETOR - Ish-kryenegociatorja në dialogun Kosovë - Serbi, Edita Tahiri, ka theksuar se po vazhdon retorika irrituese e partnerëve ndërkombëtarë rreth hetimeve të rastit të Banjskës. Ajo ka shkruar në "Facebook" se është e pakuptimtë kjo zvarritje pavarësisht prej avancimeve teknologjike,

incizimeve satelitore dhe inteligjencës artificiale. Megjithatë, Tahiri thotë se në këtë drejtim është duke e befusuar ShBA-ja. "Po vazhdon retorika irrituese e partnerëve ndërkombëtarë rreth hetimeve të rastit të Banjskës, ndërkohë që Serbia ende nuk u ndëshkua! E pakuptimtë kjo zvarritje

përkundër avancimeve teknologjike, incizimeve satelitore dhe inteligjencës artificiale! Po më befason ShBA-ja, sa për BE-në asaj i duhen muaj të tërë derisa merr vendim në mungesë të unitetit në politikën e jashtme. Kjo nuk është vetëm irrituese por edhe e rrezikshme...", ka shkruar Tahiri.



Si mbeti Kosova edhe pa termocentral, edhe pa 20 milionë euro?



PRISHTINË, 11 TETOR - Kosovës i janë shterur të gjitha mundësitë për ta sfiduar kompaninë amerikane “Contour Global” në lidhje me kontratën për Termocentralin “Kosova e Re”, thonë njohës të këtij rasti.

Tri vjet më parë Kosova përfundoi në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit, pasi kompania amerikane e fajësoi për mosrespektim të kontratës për ndërtimin e termocentralit të ri.

Javën e kaluar u bë me dije se Kosova e ka humbur arbitrazhin dhe, për më tepër, detyrohet t'i paguajë njëzet milionë euro dëmshpërblim kompanisë “Contour Global”. “E kam parë vendimin e Gjykatës [Ndërkombëtare të Arbitrazhit]. Sipas vlerësimit tim, të gjitha provat e mundshme [në favor të Kosovës] janë shterur në këtë procedurë të arbitrazhit”, thotë për “Radion Evropa e Lirë” ish-avokati i përgjithshëm shtetëror i Kosovës, Sami Istrefi.

Në Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës i thanë “Radios Evropa e Lirë” se Avokatura Shtetërore dhe përfaqësuesi i kontraktuar ligjor e kanë analizuar vendimin final të Gjykatës së Arbitrazhit dhe se do të ankohen ndaj tij në Gjykatën Civile në Mbretërinë e Bashkuar. “REL”-i kërkoi më shumë hollësi për ankesën që është menduar të bëhet, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk mori përgjigje.

Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit është institucioni kryesor i arbitrazhit në botë, që ndihmon në zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare komerciale dhe të investimeve.

Saga “Kosova e Re”

I nisur si projekt 17 vjet më parë dhe i paraparë të vihej në funksion këtë vit, Termocentrali “Kosova e Re” nuk u finalizua kurrë. Projekti fillestar u rishikua dhe u ndryshua disa herë, varësisht qeverive që merrnin pushtetin deri më 2017. Atë vit Qeveria e atëhershme e Kosovës nënshkroi marrëveshje komerciale me kompaninë amerikane “Contour Global” për ndërtimin e këtij termocentrali që do të kushtonte 1.3 miliard euro. Si i tillë projekti përfaqësonte investimin më të madh të huaj në Kosovë.

Termocentrali do të funksiononte me thëngjill dhe do të kishte kapacitet prodhimi prej 500 megavate në orë.

Me termocentralet aktuale “Kosova A” dhe “Kosova B” që, po ashtu, funksionojnë me thëngjill, Kosova ka kapacitet të prodhojë rreth 800 megavate rrymë në orë. Ndërtimi edhe i një termocentrali me thëngjill kundërshtohet vazhdimisht nga përfaqësuesit e shoqërisë civile të cilët e konsideronin si të dëmshëm për mjedisin.

Banka Botërore fillimisht i dha mbështetje projektit, duke premtuar edhe një lloj garancie që do t'i mundësonte investitorit marrjen e një kredie me interes të ulët.

Por, në vitin 2018, institucioni ndërkombëtar financiar deklaroi se nuk do ta mbështesë më ndërtimin e një termocentrali të ri me thëngjill.

Pavarësisht kësaj, “Contour

Global” tha atëkohë se nuk do të zbrapset nga realizimi i projektit. Kështu, deri në mars të vitit 2020, kur njoftoi përfundimisht tërheqjen nga projekti. Në arsyetimin e lëshuar, kompania tha se nuk do të realizojë më projekte me thëngjill, por përmendi edhe ndryshimet e vazhdueshme politike në Kosovë që kishin ndikuar në projekt.

Në kohën kur ishte nënshkruar kontrata me “Contour Global” më 2017, Qeveria e Kosovës udhëhoqë nga Ramush Haradinaj.

Kur kompania amerikane u tërhoq nga projekti, pushtetin e mbante një koalicion në mes të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Lëvizjes Vetëvendosje. Asnjëra prej këtyre partive nuk e mbështeste projektin.

Lëvizja Vetëvendosje këmbëngulte se kompania në fjalë mund ta rrisë çmimin e faturuar për shpenzimin e energjisë elektrike, ndërsa LDK-ja shprehej për ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike, por kundër alternativave investuese që shtrenjtojnë çmimin përfundimtar të energjisë elektrike.

Përveçse u tërhoq, “Contour Global” e dërgoi Kosovën edhe në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit në dhjetor 2020 për, siç u tha, mosrespektim të kontratës.

Kontrata në mes Qeverisë së Kosovës dhe kompanisë amerikane “Contour Global” parashihte që nëse Qeveria e Kosovës zvarrit kontratën duke mos i përmbushur obligimet, atëherë ajo do të ketë përgjegjësi

financiare ndaj kompanisë “Contour Global” në vlerë prej 19.7 milionë eurosh.

Sipas kontratës, nëse Kosova i përfundon obligimet, por “Contour Global” nuk arrin ta sigurojë pakon financiare, atëherë kjo kompani do t'i detyrohet Kosovës një shumë prej 17.5 milionë eurosh.

Ish-avokati i përgjithshëm shtetëror i Kosovës, Sami Istrefi, kujton se në atë kohë ekzistonte edhe një marrëveshje mes tri ndërmarrjeve publike të Kosovës: Ibër Lepencit, Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë (KOSTT) dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). “Të gjitha palët e përfshira në atë marrëveshje kanë qenë të detyruara t'i japin pëlqim ‘Contour Global’ për nisjen e ndërtimit të ‘Kosovës së Re’. Në këtë rast, KOSTT-i nuk ka dhënë pëlqim të tillë dhe, si pasojë, ka ardhur kjo gjendje çfarë është sot”, thotë Istrefi.

Ai shton se disa procedura mes palëve kanë vazhduar edhe pas tërheqjes së “Contour Global”, me këtë të fundit duke kërkuar të gjendet një zgjidhje.

Kompania amerikane, sipas Istrefit, kërkoi nga Kosova t'ia paguajë shpenzimet e bëra për fizibilitetin apo vlerësimin e projektit “Kosova e Re” në vlerë prej 6 milionë eurosh, porse Kosova nuk pranoi.

Mbyllja financiare e projektit u parapara të bëhej më 24 maj 2020, por nuk u bë.

Kuvendi i Kosovës nuk arriti t'i jepte miratimin përfundimtar ndërtimit të Termocentralit

“Kosova e Re”.

Atëkohë Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit e Kosovës tha se, pas disa tentativave për zgjidhje të kontestit me marrëveshje, investitori “Contour Global” parashitri kërkesë për arbitrazh në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit.

Pas një procesi gati trevjeçar, ky institucion vendosi në favor të kompanisë amerikane.

Sikur të ecte përpara, jetëgjatësia e Termocentralit “Kosova e Re” do të ishte 40 vjet. Qeveria e Kosovës, sipas kontratës, do ta merrte në pronësi atë pas një periudhe 20-veçare dhe pa asnjë kosto.

Me termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B” Kosova nuk arrin t'i plotësojë nevojat e mbi 1.7 milion banorëve të saj me rrymë, andaj edhe importon nga bursat e huaja. Arsye për kapacitetet jo të kënaqshme thuhet se është vjetërsia e dy termocentraleve. Sipas Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), Kosova importoi vitin e kaluar mbi 750 mijë megavate energji elektrike.

Çmimi i rrymës

Vitin e kaluar çmimi mestar i rrymës për kategorinë e konsumatorëve familjarë në Kosovë shkoi në 6.14 euro për kilovat - nga 5.60 euro sa ishte në vitin 2021. Ndërsa për konsumatorët jofamiljarë, çmimi mesatar i rrymës në vitin 2021 ishte 8.39 euro, për të shkuar në 9.27 euro në vitin 2022. Në prill të këtij viti çmimi u rrit sërish, për 15 për qind për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.

Të gjithë aktorët prapa ujqërve 'të harruar' të Hamasit



Bernard HENRY-LEVY

Është një 11 Shtator i zgjatur. Një Bataclan me raketa të lëshuara nga një minishtet fqinj. Është një pogrom arab, skenat e të cilit kujtojnë epokën e myftiut të madh pro-Hitleran, al-Husseini. Dhe asnjë argument në botë nuk mund ta justifikonte, relativizonte apo kontekstualizonte këtë krim. Pse?

Sepse asgjë nuk mund të justifikojë, qysh në krye të herës, rrëmbimin e zyrtarëve, ekzekutimin e pleqve dhe fëmijëve në distancë të afërt, zhveshjen e një gruaje lakuriq, fyerjen e saj, goditjen për vdekje dhe hedhjen tutje të gjakosur, si në një bastisje të kohëve të shkuara, mbi nje furgon.

Sepse asnjë rrethanë lehtësuese nuk mund të zbatohet për skuadrat e vdekjes që filmojnë veten duke sulmuar një festë rave, duke vrarë 260 të rinj dhe marrë peng të tjerët.

Sepse gjetja e justifikimeve për këtë, argumentimi që kjo barbari është një përgjigje ndaj shtypjes ose poshtërimit të mëparshëm, riprodhon një turp kaq të vjetër sa antisemitizmi, i cili gjithmonë

zbrret tek argumentat se, në fund të fundit, hebrenjtë janë përgjegjës për fatkeqësitë e tyre.

Por ka një arsye të dytë që ndalon të hyjmë në arsyet e këtij pogromi. Thjesht as vrasësit që hynë si ujqër në qytetet izraelite nuk kishin asnjë arsye dhe nuk u interesonte se çfarë mund të kishte thënë apo bërë kjo apo ajo qeveri izraelite.

Duke mos pasur më forcën më të vogël pushtuese në territorin e tyre për tetëmbëdhjetë vjet, ata nuk kishin pretendime territoriale për të shpallur, asnjë objektiv lufte për të kundërshtuar. Ose nëse e kishin një objektiv, nuk ishte më, po të përdorshin fjalët e von Clausewitz-it, një objektiv i saktë, një Ziel, një fitoreje e dukshme, një gjysmë fitore, një kompromis. Ishte një Zweck, një objektiv i paqartë dhe i padeklaruar dhe jo rastësisht, sepse ky objektiv nuk shprehte asgjë tjetër veç urrejtjes së pastër dhe të thjeshtë, idenë se armiku është i tepërt mbi këtë tokë dhe prandaj ekziston edhe vullneti për ta zhdukur atë.

Është ajo që në polemologji quhet një luftë totale.

Hamasi, edhe nëse nuk i ka mjetet e veta, u tha pasardhësve të të mbijetuarve të Holokaustit: "Nuk

ka asnjë vend në tokë ku të jeni të sigurt nga trashëgimtarët e Egjiptianëve, Asirianëve, Romakëve, Mesjetës dhe më pas hitlerianëve."

Epo kjo organizatë me të cilën deri tani diskutohej siguria, spitalet, doganat për qindra kamionë që kalojnë çdo ditë kufirin, ai Hamas me të cilin flitej, natyrisht, për një embargo, por vetëm për materialet që mund të përdoren për prodhimin e armëve të luftës, të cilat mundësuan që qindra hebrenj të masakroheshin të shtunën e kaluar, ditën e festës së Torës, duhet të ndëshkohet rëndë.

Por pikërisht: a ka arritur i vetëm Hamasi, me mjetet e tij të kufizuara, t'i shmanget vigjilencës së një prej shërbimeve më të mira të sigurisë në botë dhe të mbjellë vdekje dhe shkrim për ditë të tëra?

Mendoj për të riun Masud, afganin i cili më siguroi disa ditë më parë, në Paris, se shumë armë që amerikanët kishin lënë pas në Kabul u trafikuan nga talebanët, përmes Katarit, pastaj përmes Turqisë, pastaj nga deti, deri në Gaza.

Mendoj për takimin e organizuar më 27 korrik në Ankara midis

Mahmud Abbas dhe kreut të zyrës politike të Hamasit, Ismail Haniyeh, nga një Erdogan që bisedon me Izraelin në ditët çift dhe në ditët teke vendos se është një kancer.

Mendoj Sergei Lavrovin duke pritur Ismail Haniyeh me bujë të madhe në Moskë disa muaj më parë. Çfarë i thanë njëri-tjetrit? A kishte Rusia, e zhytur në luftën në Ukrainë, një interes për një front të dytë që do ta detyronte Perëndimin t'i akordonte shtetit hebre një pjesë të burimeve të çmuara ushtarake që ishin të rezervuara, në parim, për Ukrainën? Dhe çfarë merite mund t'u japim atyre që këtu, në jug të Izraelit, ku gjendem dhe unë, sigurojnë se parashutat me motorë që vrasësit përdorën për të kaluar barrierën mbrojtëse në ditëlindjen e Putinit i ngjanin në një mënyrë pothuajse të padallueshme modelit Poisk-06 MSN, të cilin rojet kufitare ruse e përdorin shpesh?

Dhe Irani... Nga njëra anë dëgjoj Antony Blinken të thotë se ai nuk ka prova për përfshirjen e Iranit në këtë masakër... Por nga ana tjetër janë ndihmat prej 6 miliardë dollarësh të lëshuara së fundmi nga bankat e Koresë së Jugut dhe

që nuk shkojnë, siç pritej, për nevoja elementare, por për blerje armësh; janë takimet e planifikimit, të cilat jam i sigurt se janë shumëfishuar muajt e fundit në Liban dhe Siri, me instruktorë iranianë që stërvisin palestinezët nga Gaza për një operacion të paprecedentë si - po e përsëris - 11 shtatori; dhe është ajo që thotë vetë Hamasi kur, nëpërmjet një prej zëdhënësve të tij, Abu Obaida, "falenderon Republikën Islamike të Iranit" që "i ka siguruar paratë, armët dhe pajisjet" që mundësuan të fillonte sulmin kundër "kalasë sioniste".


Rreth "të harruarve" të Hamasit ka jo pak njerëz.

Ka jo pak sponsorizues për një aksion që nuk kishin as mjetet ushtarake dhe as inteligjencën taktike për ta kryer vetë.

Dhe ka një lloj të ri koalicioni, në të cilin askush nuk e zbulon lojën e vet, por në të cilin të gjithë vëzhgojnë dhe testojnë qëndrueshmërinë e përgjigjes së një Izraeli të konsideruar i paprekshëm, por që duket, befas, po ul vigjilencën.

Kjo është arsyeja pse e specifikoj: Hamasi jo vetëm që duhet të ndëshkohet rëndë, por duhet të shkatërrohet.

Pse edhe sot duhet lexuar Aristotelin?



Nga: Edith HALL

Që nga mesi i shekullit XVIII, bota perëndimore ka pasur mundësi të diskutojë publikisht mbi çështjet etike, pa iu referuar Krishterimit. Mendimi modern mbi moralin, që nisët nga supozimi se perënditë nuk ekzistojnë, ose të paktën nuk ndërhyjnë, është në fillimet e veta.

Por, grekët e lashtë dhe romakët, ndërtuan shkollat e fuqishme filozofike të mendimit etik për më shumë se një mijëvjeçar, nga agnostikët e parë të shpallur, si Protagora (shek. V p.e.s.), te mendimtarët e fundit paganë. Akademia e Platonit në Athinë, nuk u mbyll përfundimisht deri në vitin 529 e.s. nga perandori bizantin Justinian.

Kjo traditë e gjatë e filozofisë morale, është një trashëgimi e çmuar e qytetërimit të lashtë të Mesdheut. Ajo ka nxitur disa mendimtarë shekullarë bashkëkohorë, të ballafaquar me boshllëkun moral të krijuar pas rënies së Krishterimit që nga fundi i viteve 1960, që të ringjallin shkollat e lashta të mendimit.

Më pak e njohur është receta e lumturisë (eudaimonia), e mbështetur nga Aristoteli. Në Liceun e tij në Athinë, ai zhvilloi një model për maksimizimin e lumturisë, që mund të zbatohet nga individë dhe shoqëri të tëra, dhe është ende i rëndësishëm sot.

Ajo u bë e njohur si “filozofia peripatetike”, pasi Aristoteli zhvilloi debate filozofike teksa shëtiste në shoqëri e me bashkëbiseduesit e vet. Parimi themelor i filozofisë peripatetike

është ky: qëllimi i jetës është të maksimizojë lumturinë duke jetuar me virtyte, duke përmbushur potencialin tuaj si njeri, dhe duke u angazhuar me të tjerët – familjen, miqtë dhe bashkëqytetarët – në aktivitete me përfitime reciproke.

Njerëzit janë kafshë, prandaj kënaqësia në përmbushjen e përgjegjshme të nevojave fizike (ngrënia, seksi) është udhëzues për të jetuar mirë. Por, meqenëse njerëzit janë kafshë të avancuara, natyrisht që priren të jetojnë së bashku në komunitete të vendosura (poliset): ne jemi “kafshë politike” (zoa politika). Njerëzit duhet të marrin përgjegjësinë për lumturinë e tyre pasi ‘zoti’ është një entitet i largët, që mund të kontrollojë lëvizjen e gjithësisë, por s’ka asnjë interes për mirëqenien e njerëzve, dhe as ndonjë funksion providencial në shpërblimin e virtytit apo ndëshkimin e imoralitetit.

Megjithatë, paramendimi i një jete më të mirë dhe më të lumtur, është i mundur pasi njerëzit kanë aftësi të lindura që u lejojnë atyre të promovojnë lulëzimin individual dhe kolektiv. Këto përfshijnë prirjet për të bërë pyetje rreth botës, për të menduar mbi veprimin dhe për të aktivizuar kujtimet e vetëdijshme.

Po çfarë donte të thoshte Aristoteli me “lumturi” ose eudaimonia? Ai nuk besonte se ajo mund të arrihej nga akumulimi i gjërave të mira në jetë – duke përfshirë të mirat materiale, statusin apo të qenit person publik – por, ishte një gjendje e brendshme dhe private e mendjes. Megjithatë, as ai nuk

besonte se ajo ishte një gjendje e vazhdueshme.

Për Aristotelin, eudaimonia kërkonte përmbushjen e potencialeve njerëzore, që nuk mund të arriheshin duke kënaqur nevojat fizike. Dhe, as nuk besonte se lumturia përcaktohet nga proporcioni total i kohës sonë të kaluar duke përjetuar kënaqësi, siç bëri edhe studenti i Sokratit, Aristipi nga Kirena.

Aristoteli këmbëngulte se lumturia është e përbërë nga diçka më e madhe dhe e ndryshme, nga një grumbullim i përvojave të këndshme. Që të jemi të lumtur, duhet të mbështesim aktivitetet konstruktive të cilat besojmë se janë të orientuara nga qëllimi. Dhe, kjo kërkon një analizë të ndërgjegjshme të qëllimeve dhe sjelljes sonë, si dhe praktikimin e “etikës së virtytit” dhe të “jetuarit mirë”.

Historikisht, shumë filozofë, si egoistët, kanë pyetur nëse virtyti është në thelb i dëshirueshëm. Por, që nga mesi i shekullit XX, të tjerët rehabilituan etikën e virtytit dhe u përqendruan intensivisht mbi idetë e Aristotelit.

Filozofi i njohur grek thotë se nëse lumturia nuk është e dërguar nga Zoti, atëherë ajo “vjen si rezultat i një mirësie, së bashku me një proces mësimi dhe përpjekje”. Çdo qenie njerëzore mund të praktikojë një mënyrë jetese që do ta bëjë atë më të lumtur.

Sipas tij, lumturia është shumë më e vështirë të mbërrihet se sa kënaqësia. Por, nuk është e pamundur. Ju nuk keni nevojë për pasuri materiale, forcë fizike

apo një pamje shumë simpatike për të filluar ushtrimin e mendjes tuaj sipas parimeve të Aristotelit, pasi mënyra e jetesës që ai mbron ka të bëjë me një përsosmëri morale dhe psikologjike, më shumë sesa një gjë që shtrihet tek pasuria materiale apo përsosmëria trupore.

Ai e pranon se ka edhe pengesa më të vështira: pasja e fëmijëve apo miqve që të zhgënjëjnë plotësisht. Një tjetër është problemi më i vështirë me të cilin përballet çdo njeri prej nesh: humbja e fëmijëve dhe miqve nëpërmjet vdekjes.

Megjithatë, është sërish e mundur që të jetojë mirë edhe pas fatkeqësive të tilla. Në këtë kuptim, Aristoteli është një optimist moral. Ka meritën se, shumë kohë përpara Sigmund Frojdit, instinktet tona biologjike janë më të natyrshme sesa sjellja në mënyrë të moralshme.

Kjo e bën etikën e tij të pajtueshme me psikanalizën moderne. Një ide inovative aristoteliane është se emocionet që supozohet të dënueshme, madje edhe zemërimi dhe hakmarrja, janë të domosdoshme për një psikikë të shëndoshë.

Në këtë drejtim, filozofia e Aristotelit është në kontrast me pikëpamjen stoike sipas së cilës zemërimi është irracional dhe një formë e çmendurisë së përkohshme, që duhet të eliminohet. Vetëm se, sipas tij, emocionet e tilla duhet të jenë të pranishme në sasinë e duhur, “mesatare” ose “të kuptueshme”. Zemërimi është gjithashtu thelbësor për një personalitet që ecën në jetë. Një individ apatik


që nuk zemërohet kurrë, që nuk ngre zërin për veten ose vartësit e tij kur duhet, dhe nuk mund të arrijë lumturinë. Megjithatë, zemërimi i tepërt apo i njerëzve, është diçka e gabuar dhe shihet prej tij si një ves.

Ndërkohë, Aristoteli është një utopik. Ai imagjionon mundësinë që të gjithë njerëzit do të jenë një ditë të aftë të kuptojnë potencialin e tyre, dhe ta shfrytëzojnë plotësisht atë. Ai parashikoi një botë futuristike, në të cilën përparimet teknologjike do ta bënë të panevojshme punën e njeriut. Edhe teoria politike e Aristotelit ishte fleksibile.

Mund të jeni kapitalist apo socialist, biznesmen apo punonjës humanitar, të votoni për thuajse çdo parti politike, dhe të jeni sërish jeni një aristotelian i qëndrueshëm. Aristoteli e dinte se njerëzit konfliktohen mes tyre, kur të mirat materiale janë të pakta: “Varfëria është prindi i revolucionit dhe krimi”.

Falë këmbënguljes së tij për të bazuar teorinë politike mbi nevojat themelore të njerëzimit, Aristoteli krijoi idetë më të avancuara ekonomike që u shfaqën ndonjëherë në kohën e tij, dhe kjo ishte arsyeja se pse e admironte Karl Marks.

Një mohues i ndryshimit të klimës, nuk mund të gjente asnjë inkurajim tek Aristoteli. Ai do të ngrinte që atë kohe alarmin për dëmet që njeriu po i shkaktonte mjedisit. Për shkak të aftësisë së unike mendore, Aristoteli, thotë që një njeri i keq mund të bëjë 10 mijë herë më shumë dëm, sesa një kafshë. /Burimi: Aeon.co/Në shqip nga: bota.al/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Prishtina rikthehet në Ligën Ballkanike

PRISHTINË, 11 TETOR - Sigal Prishtina ka bërë kërkesë zyrtare për t'u rikthyer në Ligën Ballkanike për sezonin 2023/24.

Bardhekaltrit: e kishin fituar këtë ligë dy herë, në vitet 2015 dhe 2016. Herën e fundit prishtinasit ishin pjesë e Delasport Balkan

League dy sezone më parë, kur kishin arritur deri në çerekfinale. Kryeqytetasit e kanë nisur sezonin e ri në Superligë me dy fitore dhe një

humbje. Ndërkohë, Liga Ballkanike i ka uruar mirëseardhje Sigal Prishtinës, e cila synon ta vazhdojë suksesin në këtë ligë.



Kosova shpreson në rezultat pozitiv në përballjen me Andorrën

PRISHTINË, 11 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka arritur në Andorra la Vella. Sot (e enjte) në orën 20:45 do të luajë kundër Andorrës në kuadër të kualifikimeve për "Euro 2024". Risi në listën e Kosovës janë futbollistët e ftuar nga Superliga e Kosovës: Ilir Krasniqi (Llapi), Lumbardh Dellova dhe Qëndrim Zyba (Ballkani), kurse është ftuar edhe Shkëlqim Vladi që është pjesë e Luganos në Zvicër.

Mungesa më e madhe për këtë ndeshje është ajo e kapitenit Amir Rrahmani si dhe e mbrojtësit të Torinos, Mërgim Vojvoda. Po ashtu, nuk janë ftuar edhe Arbër Zeneli, Valon Berisha, Ermal Krasniqi dhe Ibrahim Dreshviq. "Dardanët" nuk e kanë aspak mirë gjendjen në Grupin I, pasi ëndrra për

kualifikim në Kampionatin Evropian thuajse ka përfunduar. Deri tash Kosova ka regjistruar tri barazime dhe dy humbje, derisa është ende në kërkim të fitores së parë. Para kësaj ndeshje, në konferencën për medie në Prishtinë, përzgjedhësi i Kosovës, Primoz Gliha, ka vlerësuar Andorrën si një kundërshtarë mjaft të fortë për faktin se ka pasur rezultate të mira dhe se ka një mbrojtje mjaft të fortë.

Lista e futbollistëve: A. Muriq, V. Bekaj, S. Ujkani, L. Paqarada, F. Hadergjonaj, K. Hajrizi, L. Kastrati, F. Aliti, I. Beka, B. Fazliji, I. Krasniqi, L. Dellova, F. Loshaj, Q. Zyba, F. Muslija, M. Korenica, E. Zhegrova, M. Rashica, B. Berisha, E. Rashani, A. Zeqiri, Z. Bytyqi, V. Muriqi, A. Rrahmani, Sh. Vladi.



Shqipëria luan për fitore kundër Çekisë në "Air Albania"



Tiranë, 11 shtator - Kombëtarja e Shqipërisë do ta presë sonte (e enjtë) në "Air Albania" përfaqësuesen e Republikës Çeke, një përballje e vlefshme për kualifikueset e Kampionatit Evropian të Futbollit, "Euro 2024", sfidë e cila pritet të jetë vendimtare në lidhje me kualifikimin e "shqiponjave" në fazën e grupeve të kompeticionit më të rëndësishëm për ekipet kombëtare në Evropë. Kjo ndeshje do të luhet në orën 20:45. Në prag të duelit ndaj Çekisë, tekniku Sylvinho ka thënë se Kombëtarja e Shqipërisë ka "tri finale" në kuadër të kualifikueseve për "Euro 2024".

"Ne kemi tri finale përpara dhe duhet të përballemi me të njëjtin qëndrim që kemi pasur deri më tani. Gjithçka fillon të enjten (sot). Ne jemi të vetëdijshëm për entuziazmin e tifozëve tanë, por lojtarët e dinë se ky është skenari i jashtëm, diçka që ne nuk mund ta kontrollojmë. Ata janë absolutisht të qetë dhe të ndërgjegjshëm. Një fitore të enjten do të ishte një hap i madh drejt kualifikimit tonë të shumëpritur. Është jashtëzakonisht e rëndësishme, por ende nuk është përcaktuese. Ne patëm një shans të vërtetë për t'u rikthyer me një rezultat më të mirë nga ajo ndeshje, por gjëja

më e rëndësishme që morëm nga debutimi ishte se u lidhëm me lojtarët dhe ata e kuptuan menjëherë se çfarë donim", ka thënë ai.

Ndërsa trajneri i Kombëtares së Çekisë, Jaroslav Silhavy, ka thënë se është i vetëdijshëm për rëndësinë dhe vështirësinë e këtij dueli. Silhavy ka thënë për se nuk do ta kenë të lehtë përpara tifozëve shqiptarë. "Shqipëria nuk ishte një nga fuqitë e mëdha të futbollit, por nëse i hedhim një sy skuadrës së tyre, ka shumë lojtarë nga Seria A italiane dhe nga kompeticionet evropiane. Shtoji këtu edhe tifozët fanatikë në korridore", ka thënë Silhavy.

Zyrtare: Wayne Rooney emërohet trajner i Birmingham City

Londër, 11 tetor - Skuadra angleze Birmingham City ka njoftuar se Wayne Rooney është trajner i ri i klubit pas vendimit për shkarkimin e John Eustaces. Rooney është rikthyer në futbollin anglez

pasi ka rënë dakord për një marrëveshje për ta marrë drejtimin e skuadrës së Championshipit, Birmingham City. Ish-sulmuesi i Anglisë dhe Manchester Unitedit ka rënë dakord për një

kontratë trevjeçare e gjysmë me skuadrën e "St Andrew's". "Klubi i futbollit i Birmingham Cityt ka kënaqësinë të njoftojë për emërimin e Wayne Rooneyt trajner, duke rënë dakord për kushtet për një

kontratë trevjeçare e gjysmë. Ai fillon me efekt të menjëhershëm, pasi u largua së fundi nga pozita e tij trajner i ekipit të Major League Soccer D. C. United", ka njoftuar Birmingham City.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Dervish Muqaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "PjetërBudi".

- Kastriot Rexha shpall të pavlefshme certifikatën e numrit Fiskal me nr. 601773494.

- D.P.H. "Burimi" shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330286147-Gjilan.

- Bulent Bytyqi shpall te pavlefshme 4 dëftesat shme " Ymer Prizreni "Prizren.

- Fikret Ajazaj shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Egzona Rrustemi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. dhjetë (X), njëmbëdhjetë (XI) dymbëdhjetë (XII) si dhe Diplomën e Gjimnazit "Naim Frashëri" Shtime.

- AGRON PEÇI, shpall te pavlefshme dëftesën 1-8 SHFMU "MUHARREM BEKTESHI".

- KENAN JONUZI, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme te larte "ARKITEKT SINANI".

- BEKIM PEÇI, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "ISMAIL QEMALI".

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

